



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Povel za žalbe i Predstavke



ZL.Anr.383/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Adem Bucollit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, paraqitur kundër Agron Qorrit, kryesues i Vendvotimit (VV) në Drenas, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr.383/2017 e datës 23.10.2017 e Adem Bucollit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Drenas.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Adem Bucolli nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, me të cilën pretendon se në Vendvotimin 0324E/012 në Vsilev të Drenasit, gjatë numërimit të votave ka ndodhur një gabim teknik dhe se lidhur me këtë pajtohet edhe kryesuesi i vendvotimit në fjalë sipas të cilit gabimi ka ndodhur pa qëllim. Andaj parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që të verifikohen votat e tij në QNR.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me gabimin në numërimin e votave, në vendvotimin e cekur në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërliken me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi për shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedh si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës të ankuesit nuk e

paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 383/2017 me datën 24.10.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-